



Raport vjetor 2025

QENDRA RINORE ARDHMËRIA– KLINË

KOSOVË

1 Janar & 31 Dhjetor 2025

PERGADITUR NGA: VITORE ZEFI

ME 31/12/2025

KLINË



Hyrje:

Qendra Rinore Ardhmëria-Klinë është themeluar në vitin 1999, që prej këtij viti qendra organizon aktivitete për të rinjë dhe gjithashtu edhe këtë vit janë zhvilluar programet dhe iniciativat rinore. Në këtë raport janë të përmbledhura të gjitha aktivitetet dhe projektet e realizuara në Qender Rinore Ardhmëria-Klinë gjatë vitit kalendarik 2025.

Aktivitetet e qendrës rinore Ardhmëria-Klinë të cilat janë zhvilluar dhe janë të vazhdueshme:

- 1. KURSET E PERDITSHME**
- 2. AKTIVITETET DHE INICIATIVAT RINORE**
- 3. BASHKËPUNIMET & PARTNERITET**
- 4. PROJEKTET**
- 5. STATISTIKAT /PËRFITUESIT**

1. KURSET E PERDITSHME



1.1 KURSI I GJUHËS GJERMANE

Në menyrë të rregullt ditore është organizuar kursi i gjuhës Gjermane për fëmijë dhe të rritur. Çdo ditë gjatë vitit këtij viti kanë përfituar shumë pjesëmarrës të cilët kanë ndjekur kursin e gjuhës Gjermane. Kurset e gjuhës gjermane për fëmijë dhe të rritur gjatë vitit 2025 janë udhëhequr nga vullnetari Gjerman (European Solidarity Corps) Finn Lempert. Secili Grup i gjuhës gjermane është zhvilluar 2 (dy) orë në javë (2 grupe) dhe kanë zgjatur 3(tre) muaj.



1.2 KURSI I GJUHËS ANGLEZE

Ndërsa Kursi i gjuhës angleze për të rinjë moshë 14-18 vjeç është zhvilluar nga vullnetari amerikan (Peace Corps-Aaron Vajrelas). Grupi i gjuhës Angleze është zhvilluar 2 (dy) orë në javë gjithsejt është zhvilluar (1 grup) dhe ka zgjatur 2 (dy) muaj.



1.3 WORKSHOPET- PSIKO SOCIALE

Workshoptet Psiko-Sociale me fëmijë, kishin për qëllim të nxisë shprehjen e emocioneve, komunikimin dhe bashkëpunimin mes tyre. Përmes lojërave interaktive, diskutimeve të udhëhequra nga studentja e psikologjisë Puhizë Behramaj dhe ushtrimeve kreative, fëmijët patën mundësinë të ndihen të dëgjuar, të kuptuar dhe të angazhuar në një ambient të sigurt dhe mbështetës. Workshoptet janë zhvilluar 3 muaj, dhe fëmijet kanë pasur mundësi të marrin pjesë çdo të premte (dy ore në ditë). Nga këto workshoptet kanë përfituar 25 nxënës të moshës 7-10 Vjeç.

Zhvilluar prej shtator-Dhjetor 2025



1.4 TEMA SOCIALE PËR TE RINJE

Puntorit e rregullta rreth Temave sociale janë zhvilluar nga vet të rinjtë vullnetarë, pasi që është shumë e vlefshme për të rinjtë, të takohen dhe të diskutojnë rreth përshtypjeve sociale, ndikimit që ato kanë në jetën tonë të përditshme dhe mënyrës se si formohen.

Gjatë puntorive janë analizuar raste konkrete nga jeta e përditshme për të kuptuar më mirë si krijohen dhe ndikojnë përshtypjet sociale. Punuan në shembuj praktikë, për të reflektuar mbi përvojat personale dhe për të zhvilluar aftësi kritike në raport me stereotipet dhe paragjykimet. Secili aktivitet ka nxitur debat të shëndetshëm, reflektim dhe ndihmoi të rinjtë të kuptojnë më mirë veten dhe shoqërinë ku jetojnë.

Grupi I të rinjeve është takuar dy herë në muaj.

Zhvilluar prej Tetor-Dhjetor 2025



2. AKTIVITETET & INICIATIVAT RINORE:

2.1 DITA E PAVARSISË SË KOSOVES

Qendra Rinore organizoi një festë fantastike dhe kuptimplotë të Ditës së Pavarësisë së Kosovës! Aktivitetet që kemi organizuar—si dokumentari historik, diskutimi rreth çështjeve të rinjve dhe kuizi i njohurive—ishin tejet tërheqëse dhe edukative. Është e mrekullueshme të shohësh të rinj që janë shumë aktive dhe vullnetarë për të kontribuar në ngjarjen kulturore. Bashkëpunimi me pedagoge si Merita Lecaj dhe puna e palodhur e të gjithë vullnetarëve padyshim që ndihmuan në suksesin e këtij eventi.

Urime të gjithë të përfshirëve dhe urime 17 vjetori i Pavarësisë së Kosovës! 🎉



Zhvilluar
me 17
Shkurt
2025

2.2 TRAJNIM-RËNDËSIA E MENDIMIT POZITIV NË SHOQËRI

Trajnim mbi Rëndësinë e të menduarit pozitiv është mbajtur një trajnim për të rinjtë me temën “Rëndësia e të menduarit pozitiv në shoqëri”. Qëllimi i trajnimit ishte edukimi i të rinjve për rëndësinë e forcimit të një imazhi pozitiv për veten dhe pajisja e tyre me mjete praktike për kultivimin e të menduarit pozitiv.

Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit u njohën me teknika efektive që do t'i lejojnë ata të eksplorojnë aspekte të reja të vetes, të cilat mund të mos kenë pasur mundësi t'i zbulojnë më parë. Këto metoda u përqendruan në rregullimin emocional dhe vetë-menaxhimin, duke ndihmuar pjesëmarrësit të kuptojnë se rrethanat e jashtme shpesh pasqyrojnë gjendjen tonë të brendshme të qenies. Sesionin e udhëhoqi **Liridona Gashi**, e diplomuar në shkencat sociale. Ajo ndau njohuri të vlefshme, duke i udhëhequr të rinjtë përmes ushtrimeve që inkurajonin vetë-reflektimin dhe rritjen personale. Nëpërmjet këtyre ushtrimeve, pjesëmarrësit fituan një kuptim më të thellë se si të menduarit pozitiv mund të transformojë perspektivat e tyre për jetën dhe të përmirësojë mirëqenien e tyre.



Zhvilluar me 10 Mars 2025

2.3 DITA NDËRKOMBËTARE E UJIT Dita Botërore e Ujit është një ditë e përvitshme e Kombeve të Bashkuara (OKB) që mbahet më 22 mars, e cila thekson rëndësinë e ujit. Dita përdoret për të avokuar për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve të ujërave dhe pikërisht në këtë ditë grupi rinor vizitoi IMPANTIN e Ujit të Klinës. Të rinjtë paten mundësi që gjatë

vizites të bisedojn dhe diskutojn me përfaqësuesit e kompanisë HIDRODRINI në Klinë ku edhe moren njohuri për systemin e ujit të pijshem dhe funksionimin e këtij IMPANITI. Gjithashtu ekspertet nga HIDRODRINI inkurajuan dhe frymëzuan të rinjtë që të mësojnë më shumë rreth çështjeve të lidhura me ujin dhe të ndërmarrin iniciativa për të bërë ndryshime në lagjet dhe vendin ku jetojn. Grupin rinor e Mirëpriti ekpi I Kompanis HIDRODRINI në Klinë.



Zhvilluar me 21 Mars 2025

2.4 DITA E TOKES- AKSION PASTRIMI

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Mjedisit, një grup të rinjsh aktivistë nga Klina organizuan një aksion pastrimi në kuadër të një nisme për vetëdijesim mjedisor dhe përfshirje rinore. Aktiviteti përfshiu pastrimin e brigjeve të lumit dhe parkut të qytetit, ku morën pjesë nxënës, vullnetarë të Qendres rinore si dhe qytetari aktiv [#RagipKryeziu](#)

Të pajisur me doreza, thasë mbeturinash dhe perkushtim të madh, të rinjtë arritën të mbledhin një sasi të konsiderueshme mbeturinash, duke dhënë një kontribut të rëndësishëm për një mjedis më të pastër dhe të shëndetshëm në qytetin e tyre. Ky aktivitet gjithashtu shërbeu si një mundësi për të ndërgjegjësuar bashkëmoshatarët dhe banorët për rëndësinë e ruajtjes së natyrës dhe reduktimit të ndotjes.

Kjo nismë thekson rolin kyç që të rinjtë kanë në ndërtimin e një të ardhme të qëndrueshme, si dhe fuqinë e veprimit të përbashkët në nivel lokal.



Zhvilluar me 24 Prill 2025

2.5 DITA BOTËRORE KUNDER DUHANIT

Me 31 Maj, në ditën botërore kundër duhanit kemi organizuar një aktivitet edukativ me temën “Zgjedh shendetin jo duhanin”. Të rinjtë, vullnetarë të Qendrës Rinore u bënë zëri i ndryshimit duke organizuar një aktivitet ndërgjegjësues përmes një dokumentari edukues për nxënësit e

shkollave. Përmes këtij materiali, ata jo vetëm që u informuan mbi rreziqet e duhanit, por treguan fuqinë e tyre si liderë dhe model pozitiv për bashkëmoshatarët. Një hap i vogël, por me ndikim të madh drejt një të ardhme më të shëndetshme. Aktiviteti është organizuar me nxënësit e shfmu "Motrat Qiriazit" në Klinë.



Zhvilluar me 31 Maj 2025

2.6 FESTA E 1 QERSHORIT

1 Qershori është një ditë e veçantë për të gjithë fëmijët në mbarë botën, dhe edhe në qytetin tonë të Klinës, kjo ditë u shënua me gëzim, lojëra dhe shumë buzëqeshje. Vullnetarët e Qendrës Rinore "Ardhmëria-Klinë" organizuan një festë të gjallë në parkun e qytetit "Irir Merturi", ku fëmijët e moshave të ndryshme morën pjesë në aktivitete kreative dhe argëtuese.

Përmes shumë lojërave dhe aktiviteteve të ndryshme, të rinjtë u angazhuan që ta bëjnë këtë ditë sa më të bukur për më të vegjlit. Pjesëmarrja ishte e madhe, dhe buzëqeshjet në fytyrat e fëmijëve ishin dëshmi e gëzimit të tyre të sinqertë. Festa e Qershorit në Klinë u mbështet nga organizata zvicerane Smile Together, dhe u realizua në bashkëpunim me organizatat partnere Syri i Vizionit dhe Qendra Rinore "Ardhmëria-Klinë", të cilat luajtën një rol kyç në organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve që i dhanë ngjyra kësaj dite të veçantë.



2.7 PUNTORI

"Pjesëmarrja e vajzave buxhetore" KAB në Ky takim është **Rinore Ardhmëria**

pjesë një numer i madh shpalosen problemet dhe idet e tyre për buxhetin e ardhshëm në komunën tonë, gjithashtu kontribut në këtë puntori dha edhe zyrtarja për Informim znj. Vlora Tafili. Puntoria është udhëhequr nga Mitrovica Women Association for Human Rights.



INFORMATIVE

në takimet komunën e Klinës. zhvilluar në **Qendra Klinë** dhe moren të rejash që

Zhvilluar me 16 Qershor 2025



2.7 PROGRAMI VEROR

Kampi veror është realizuar gjatë muajve të verës në qender rinore si dhe në Parkun e qytetit. Stafi i Qendrës dhe Trajnerët kanë realizuar 3 mbledhje trajnuese/informative për vullntarët. Takimet trajnuese u realizuan për përgatitjen e Kampit veror me fëmijë. Qëllimi i këtij

programi është që të motivojmë të rinjtë të punojnë me fëmijë dhe njëkohësisht të zhvillojnë aftësitë dhe kapacitetet rinore në organizim, menaxhim dhe lidhshmëri. Pas informimit të vullnetarëve, trajnimit të tyre dhe përcaktimit të agjendes dhe kalendarit për Kamp Veror I cili është zhvilluar gjatë muajit korrik dhe ka zgjatur 14 ditë gjatë këtyre ditëve të ngrohta korriku çdo ditë kemi ofruar Workshope për 30 fëmijë, lojra edukative dhe argetuese.



2.8 SESION INFORMUES

Qendra Rinore “Ardhmeria” pati kënaqësinë të bashkëpunonte në fushatën informuese të Projektit: Integra rreth të rinjve që migrojnë nga Kosova. Temat përfshinin se si mund ta luftojmë këtë largim të të rinjve dhe të krijojmë mundësi që plotësojnë nevojat e brezit të ri që së shpejti do të udhëheqin qytetin e madh të Klinës. Kishim shumë pjesëmarrës nga prejardhje dhe moshë të ndryshme. Duam të falënderojmë bashkëpunimin e projektit “PRED plus” për punën e tyre dhe drejtimin e sesionit informues! “Rri në Kosovë, se ma mirë s’ka”

Zhvilluar me 31 Korrik 2025



2.9 SESION INFORMUES PËR VULLNETARIZEM-SFERKË

Sesioni Informues për vullnetarizmin në SHFMU “Emin Duraku” në Sferkë. Me 2 Tetor patëm kënaqësinë të mbajmë një sesion informues me të rinjtë e shkollës fillore “Emin Duraku” në Sferkë, ku prezantuar programet dhe mundësitë që ofron Qendra Rinore “Ardhmeria” – Klinë. Qëllimi i këtij takimi ishte që nxënësit të njihen më shumë me aktivitetet rinore, hapësirat kreative dhe mundësitë për angazhim aktiv në komunitet. Faleminderit stafit të shkollës dhe të rinjve për pjesëmarrjen dhe interesimin e treguar!
Zhvilluar me 3 Tetor 2025.



2.10 SESION INFORMUES PËR VULLNETARIZEM-KLINË

Zhvilluam një sesion informues me të rinjtë shkollës së mesme “Fehmi Agani” në Klinë, rreth mundësive të Vullnetarizimit që ofron Qendra Rinore “Ardhmëria-Klinë”!

Diskutuam për aktivitetet, programet dhe hapësirat qëi ndihmojnë të rinjtë të zhvillojnë aftësitë e tyre dhe të përfshihen më shumë në jetën komunitare.

Gjithashtu gjatë këtij sesioni, të rinjtë patën mundësinë të njihen edhe me dy nga vullnetaret tonë ndërkombëtar (European Solidarity Corps dhe Korpusi I paqes amerikan), të cilët janë pjesë e qendrës rinore. Me përvojat dhe energjinë e tyre pozitive, ato shërbyen si frymëzim dhe motivim për të rinjtë, duke ndarë histori personale dhe këshilla të vlefshme për rritje personale dhe angazhim në komunitet.



Zhvilluar me 9 Tetor 2025

2.11 NGJARJE KULTURORE „HALLOWEEN“ 🧛‍♀️

Me mbështetjen e vullnetarëve tanë të përkushtuar, zhvilluam me sukses një aktivitet të bukur dhe plot gjallëri me rastin e Halloween-it. Fëmijët patën mundësinë të pikturonin fytyrat, të merrnin pjesë në lojëra argëtuese dhe të shijonin ëmbëlsira, duke kaluar momente të gëzueshme me bashkëmohatarët e tyre.

Shprehim mirënjohjen tonë të sinqertë për të gjithë ata që morën pjesë dhe kontribuan në krijimin e një atmosfere festive dhe të paharrueshme këtë të premtë. ❤️

Zhvilluar me 31 Tetor 2025.



2.12 DITA E TË DREJTAVE TË FEMIJËVE -20 NËNTORI

Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve është kthyer jo vetëm në një ditë festive, por edhe në një ditë për ti thënë jo dhunës dhe abuzimit ndaj fëmijëve. Është dita kur vetë fëmijët shprehen lirshëm për të thënë të drejtat e tyre.

Sot u zhvillua një aktivitet i veçantë mbi të drejtat e fëmijëve, organizuar nga Qendra Rinore në bashkëpunim me shkollën fillore "Motrat Qiriazit" Klinë. Nxënësit morën pjesë në diskutime dhe lojëra edukative që ndihmuan në kuptimin e rëndësisë së mbrojtjes dhe barazisë. Ata punuan në grupe për të krijuar postera dhe mesazhe ndërgjegjësuese. Aktiviteti nxiti bashkëpunimin, kreativitetin dhe të menduarit kritik. Në fund, fëmijët ndanë idetë e tyre për mënyrat se si mund të kontribuojnë në një mjedis më të sigurt dhe më përfshirës për të gjithë.

Zhvilluar me 20 Nentor



2.13 TRAJNIM -NËRERGJËGJSUES

Të rinjtë e Qendrës Rinore zhvilluan një Trajnim informues dhe ndërgjegjësuës të dedikuar temës së HIV/AIDS, me qëllim rritjen e dijes dhe përgjegjësisë tek të rinjtë. Gjatë aktivitetit u prezantuan informacione kryesore mbi mënyrat e transmetimit, mënyrat e mbrojtjes, rëndësinë e testimit të rregullt dhe thyerjen e tabuve që shoqërojnë këtë temë.

Vullnetarët organizuan diskutime të hapura, shpërndanë materiale edukative dhe inkurajuan pjesëmarrësit të bëjnë pyetje, duke krijuar një atmosferë të sigurt dhe miqësore. Të rinjtë patën mundësinë të përfshihen në aktivitete interaktive që theksuan rëndësinë e informimit të saktë dhe të sjelljes së përgjegjshme.

Ky aktivitet jo vetëm që kontribuoi në rritjen e vetëdijes, por gjithashtu forcoi rolin e të rinjve si promotorë të shëndetit dhe mirëqenies në komunitet.



Zhvilluar me 1 Dhjetor 2025

2.14 AKTIVITETET HUMANITARE

Bizneset Private: Dy grupe të të vullnetareve kanë vizitur bizneset e qytetit të Klinës në mënyrë që të mbledhim fonde për bamirësi, dhe mund të shprehemi se më shumë përkrahje kemi pasur nga bizneset e vogëla sesa nga ato biznese të mëdha.

Punimi i kartolinave: Vullnetaret punuan kartolinat e festave të fundvitit të cilat janë shitur në qendër të qytetit me qëllim për të ngritur fondin për familjet në nevojë.

Shitja e embëlsirave: Të rinjtë organizuan që secili prej tyre të gatujnë embëlsira dhe torte në shtëpi dhe ato ti sjellin në grup që se bashku dy ditë të ftoftë dimri të shesin në qytet.



SHPERNDARJA E NDIHMAVE HUMANITARE 2025 ishte një ditë që na kujtoi sa shumë vlerë ka solidariteti dhe mirësia. Falë përkushtimit të vullnetarëve të Qendrës Rinore Ardhmeria, të cilët me dashuri përgatitën dhe shitën kartolina e ëmbëlsira, si dhe kerkuan mbështetje nga bizneset dhe njerëzit vullnet mirë u arrit të mblidhej një fond që u kthye në ndihmë konkrete për familjet në nevojë. Çdo kartolinë mbante një mesazh shprese, çdo ëmbëlsirë një buzëqeshje të dhuruar, dhe çdo kontribut ishte një hap më afër për të lehtësuar barrën e atyre që kanë më shumë nevojë.

Shpërndarja e ndihmave nuk ishte thjesht një akt humanitar, por një moment i mbushur me emocione, mirënjohje dhe ndjesinë e fortë se bashkë mund të bëjmë ndryshim. Falënderime pa fund për secilin qytetar që kontribuoi me zemër të hapur dhe të gjitha bizneseve të Komunës së Klinës që na qëndruan pranë dhe besuan në këtë nismë, si dhe për gjithë mundin, përkushtimin dhe punën e palodhshme të vullnetarëve që e bënë të mundur realizimin e këtij projekti humanitar. Pa ju, kjo vepër mirësie nuk do të mund të realizohej.



2.15 PUNTORI EDUKATIVE

Qëllimi i punëtorisë ishte të rrisë ndërgjegjësimin mbi rolin kyç të gjuhës në zhvillimin e hershëm dhe në suksesin akademik, si dhe mbi rëndësinë e referimit të hershëm për mbështetje profesionale.

Faleminderit të gjithë pjesëmarrësve për angazhimin, diskutimet e hapura dhe vullnetin për të ndërtuar mjedise më gjithëpërfshirëse dhe më të pasura gjuhësisht për fëmijët tanë.

Puntoria I'u ishte dedikuar edukatoreve dhe nënave, në këtë puntori moren pjesë 15 Edukator dhe 5 prinder. Puntoria ishte Iniciatve e profesoreshes Eda Geci, e cila me shume perkushtim e realizoi kete puntori nëpërmjet një bashkëpunimi të ngushtë me Drejtorinë e Arsimit në Klinikë dhe Qendrën Rinore "Ardhmëria", si dhe me një ekip multidisiplinar të angazhuar në çdo hap të organizimit dhe trajnimit. Gjithashtu nje vullnetare si Dr. Behare Bojaxhiu dhe bashkëpunëtoren e saj Urtina Sopi nga Qendra e Shëndetit Mendor në Prishtinë, dhane një kontributi të vyer në trajnimin e mësuesve dhe prindërve mbi identifikimin e hershëm të shenjave të vonesave dhe çrregullimeve në të folur.



Z
h
v
i
l
l
u
a
r
m
e
1
5

dhjetor 2025

2.16 Christmas party/ Festë përmbyllese e vitit

Qendra Rinore "Ardhmëria-Klinë", po përfundon një vit me shumë aktivitete të cilat i festuam me një party me muzik, karaoke dhe aheng ku morën pjesë grupi i vullnetarëve të cilët në fund u certifikuan për punën vullnetare gjatë vitit 2025.

Ju urojmë të gjithëve Krishtilindjen dhe Vitin e Ri 2026!

1 BASHKËPUNIME DHE PARTNERËT

2.1 PARTNERSHIP –CHRISTEN FUR EVROPA-DRESDEN GERMANY

Sending: Organizata ICE partnere nga Gjermania ka përzgjedhur 1 vullnetar nga (Dugajeva) Klina .

1. FSJ, Adrian Gojani për të punuar si vullnetar e ne programin gjerman FSJ në Dresden në periudhë 12 mujore, projekti filloi në Gusht 2024 dhe perfundoi ne Gusht 2025. Projekti është i financuar nga fondi I vullnetareve gjerman me qellim që të zhvillohen aftësitë rinore dhe për të shkëmbyer kultura të ndryshme.

Zhvilluar prej 1 Shtator 2024- 30 Gusht 2025

2.2 PARTNERSHIP –STEINBEIS INNOVATION GMBH / INNOVATION CENTRE STUTTGART, GERMANY

Sending: Organizata Steinbeis partnere nga Gjermania ka përzgjedhur 1 vullnetare nga (Gjurgjeviku I madh) Klina .



1. ESC, Edona Berisha për të punuar si vullnetar e ne programin Evropian në Friebrug në periudhë 12 mujore. Projekti filloi në Janar 2025 dhe perfundoi ne Dhjetor 2025.

2.3 PARTNERSHIP –CHRISTEN FUR EVROPA-DRESDEN GERMANY

Hosting: Organizata ICE ka vendosur qe te dergoj nje vullnetar nga Dresden ne peridhe 12 mujore.

1. ESC- Finn Lampert Rasmus, ka filluar missionin ne QRAK ne shtator te vitit 2025- Gusht 2026.

2.4 BASHKEPUNIM – KORPUSI I PAQES.

Organizata amerikane Korpusi i paqes ka sjellur tek ne një vullnetar (Aaron Vajrelas), për të punuar si vullnetar i korpusit të paqes në Klinikë në periudhë prej 24 muajve. Aktiviteti ka filluar në Mars 2025 . Vullnetari vazhdoi te punoj në menaxhmentin e Qendres Rinore dhe te mbeshtes ekipin punues të projekteve deri në fund te Marsit 2027.

Zhvilluar nga Mars 2025-vazhdon.

2 PROJEKTET

PROJEKTI-ZHVILLIMI I RINISE NE KOSOVE

Projekti “Zhvillimi i Rinise ne Klinikë” është organizuar nga Qendra Rinore Ardhmeria-Klinikë me përkrahjen e Subvencionit të Komunës së Klinikës dhe gjëgjësisht Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport. Projekti mundësoi realizimin e aktiviteteve: Ligjerata për vetëdijësim dhe parandalimin e sëmundjeve infektuese , Ligjerata per vetëdijësimin e higjenës personale, Workshop për zhvillim të aftësive të buta Fushatë motivuese për iniciativat rinore në komunitet.

Mars-Dhjetor 2025

3 STATISTIKAT /PËRFITUESIT

